VENDIM
Nr. 365, datë 22.6.2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 43, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FUNKSIONIMIN E PROCESIT TË SHKËMBIMIT TË DOKUMENTEVE NDËRMJET INSTITUCIONEVE, NËPËRMJET SISTEMIT TË QARKULLIMIT TË DOKUMENTEVE ME NËNSHKRIM ELEKTRONIK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27, të ligjit nr. 107/2015, "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 43, datë 15.1.2020, Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun II bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Në fund të titullit të kreut shtohen fjalët "... MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT";

b) Pika 4 ndryshohet si më poshtë si vijon:

"4. Nëpunësi publik është i detyruar që kërkesën për ndihmë administrative, për kryerjen e një ose disa veprimeve të nevojshme, veçanërisht për njohjen me dokumente, fakte apo mjete të tjera të provës, në administrim të organit tjetër, sipas përcaktimit të nenit 71, të Kodit të Procedurës Administrative, ta dërgojë jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë nga paraqitja e kërkesës nga kërkuesi. Në çdo rast, ndihma administrative, sipas kësaj pike, kërkohet nëpërmjet SQDNE-së.".

c) Në pikën 11, fjalët "... pika 7..." zëvendësohen me "... pika 10...".

ç) Pika 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"13. Në mënyrë që të zbatohen afatet për shërbimin ndaj qytetarit, nëpunësit, eprori apo titullari do të kenë mundësinë e monitorimit nëpërmjet sistemit për të verifikuar statusin e kërkesës. Çdo nëpunës publik duhet të vetëdeklarojë, nëpërmjet sistemit, në ofrimin e shërbimit ose statusin e kërkesës, duke përfshirë dhe datën në të cilën është ofruar ky shërbim te qytetari ose subjekti që ka bërë kërkesën.".

d) Pas pikës 13 shtohen pikat 13/1, 13/2 dhe 13/3, me këtë përmbajtje:

"13/1. Lëvrimi i shërbimeve nga të gjitha institucionet shërbimofruese të kërkesave të bëra nga platforma *e-Albania* do të realizohet vetëm elektronikisht, duke siguruar lëshimin e dokumentit përfundimtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.

13/2. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është institucioni përgjegjës për monitorimin e raportimin e zbatimit të afateve dhe përdorimit të SQDNE-së, në rastet kur duhet të ketë shkëmbim dokumentacioni shoqërues ndërmjet institucioneve, deri në marrjen e shërbimit nga subjektet kërkuese në portalin qeveritar *e-Albania*, sipas afateve ligjore.

13/3. Nëpunësit publikë përgjegjës raportojnë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje për vonesat, kërkesat e refuzuara apo gabimet gjatë procesit për kërkim dokumentacioni, ofrimin e shërbimit dhe masat e marra nga institucioni në rast vonese në ofrimin e shërbimit.".

2. Pika 16, e kreut III, ndryshohet si më poshtë vijon:

"16. Për shkelje të rënda ose të përsëritura, të ndodhura brenda një institucioni ose kur konstatohet se shkeljet janë pasojë e mosorganizimit të brendshëm të punës në institucion, eprori direkt i nëpunësit publik:

a) trajtohet sipas përcaktimeve dhe procedurave të legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin kur ai është nëpunës civil;

b) merr masë administrative, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës, në rastin kur marrëdhënia e tij e punës rregullohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës apo me ligj të posaçëm.”.

II. Ngarkohen Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe institucionet e administratës publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe